



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 2713 Prot.

Fier më 27/02/2026

PROJEKT- VENDIM

Nr. 25, datë 27/02/2026

PER NJE NDRYSHIM NE VKB NR.12 DATE 29.01.2026 "PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA, QËBANOJNË ME QIRA NË TREGUN E LIRË DHE NUK KANË TË ARDHURA TË MJAFTUESHME PËR TA PËRBALLUAR VETË GJITHË VLERËN E QIRASË"

Në mbështetje të Ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, neni 2, pikat 1, 4, 20, 25, 26, 27, 29, 30, 33, 34, neni 37, 42, neni 4, neni 20, nenet 33, 34, 36, 38 dhe 39, VKM nr.384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore", VKM Nr.459 datë 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", VKM nr.301, datë 15.04.2020, "Për normat e strehimit", VKM nr. 362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKB nr. 112, datë 27.11.2025 "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe miratimin e vlerës mesatare të qirasë në tregun e lirë, për efekt të llogaritjes së masës së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij për vitin 2026, Vendimin e Keshillit Bashkiak Fier nr.12, date 29.01.2026 " Për miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë", si dhe shkresës zyrtare nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit , Drejtoria e Strehimit me Nr.628/2, datë 23.01.2026, "Mbi fondet për programit e strehimit për vitin 2026", të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 24, gërma k,

Propozon :

1. Ndryshimin e pikes 2 te VKB Nr. 12 ,datë, 29.01.2026 " Për miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë" , si me poshtë:

Ishte

- Vlera financiare e subvencionit të qirasë do të mbulohen në masën 80% nga buxheti i shtetit dhe 20% nga Buxheti i Bashkisë Fier për vitin 2026.

Behet

- Vlera financiare e subvencionit të qirasë do të mbulohen në masën 70% nga buxheti i shtetit dhe 30% nga Buxheti i Bashkisë Fier për vitin 2026.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Shërbimeve Sociale si dhe Drejtoria e Financë -Buxhetit.

Konc.N.Sollaku

Drejtoria e Finance – Buxhetit
Pranvera Cina

Drejtoria Juridike
Esmeralda Kapllanaj

KRYETAR

ARMANDO SUBASHI

NË MUNGESË E ME AUTORIZIM

ZV/KRYETAR

MIRELA PITUSHI

